



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-066

Prishtinë, më 5 korrik 2019, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 5 KORRIK 2019

**Në mbledhje morën pjesë:** Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Kujtim Shala, Aida Dërguti dhe Mufera Srbica-Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit:** Avni Bytyqi.

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Shefki Shoshaj.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, i zhvilloi punimet me këtë:

### **Rend dite**

1. Propozim-Vendimi për Projektin: Zhvillimi i Sistemit Informativ Ligjor (Law-Data System) për Kuvendin e Republikës së Kosovës Sistemi për harmonizim gjuhësor të ligjeve

Kryetari i njoftoi të pranishmit me Propozim-Vendimin për Projektin: Zhvillimi i Sistemit Informativ Ligjor (Law-Data System) për Kuvendin e Republikës së Kosovës Sistemi për harmonizim gjuhësor të ligjeve.

Lidhur me Propozimin-Vendimin e lartshënuar, diskutuan: nënkryetarja e Kuvendit, Aida Dërguti dhe Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, i cili anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit ia prezantoi shkurtimisht, si dhe i dha sqarimet për Projektin: “Zhvillimi i Sistemit Informativ Ligjor (Law-Data System) për Kuvendin e Republikës së Kosovës Sistemi për harmonizim gjuhësor të ligjeve”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, Kryesia, mori këtë:

### **V E N D I M**

1. Miratohet Projekti: “Zhvillimi i Sistemit Informativ Ligjor (Law-Data-System) për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Sistemi për harmonizim gjuhësor të ligjeve”.
2. Financimi i Projektit nga pika 1 e këtij Vendimi bëhet nga Ambasada e Norvegjisë në Kosovë, në shumën 2.387.951,30 euro, për tri (3) vite.
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës, për Projektin nga pika 1 e këtij Vendimi, participon në shumën 250.000,00 euro, për tri (3) vite.
4. Mbikëqyrja e zbatimit të Projektit: “Zhvillimi i Sistemit Informativ Ligjor (Law-Data-System) për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Sistemi për harmonizim gjuhësor të ligjeve, bëhet nga Kryesia e Kuvendit.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 12:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*